



Originali: anglisht

Nr.: ICC-01/11-01/11

Data: 4 korrik 2011

DHOMA PARA-GJ YQËSORE I

Para: Gjyqtarja Sanji Mmasenono Monageng, Kryetare e Trupit Gkykues
Gjyqtarja Sylvia Steiner
Gjyqtari Cuno Tarfusser

SITUATA NË XHAMAHIRINË ARABE TË LIBISË

NË LËNDËN

**PROKURORI kundër MUAMMAR MOHAMMED ABU MINYAR GADDAFI-t,
SAIF AL-ISLAM GADDAFI-t dhe ABDULLAH AL-SENUSSI-t**

Dokument Publik

**Kërkesë të gjitha Shteteve Palë të Statutit për arrestimin dhe dorëzimin e Muammar
Mohammed Abu GADDAFI-t, Saif Al-Islam GADDAFI-t dhe Abdullah AL-
SENUSSI-t**

Burimi: Sekretaria e Gjykatës

Të njoftohen me vendimin në përputhje me rregulloren 31 të *Rregulloreve të Gjykatës*:

Zyra e Prokurorit

Z. Luis Moreno-Ocampo, Prokuror
Z-(ush)a Fatou Bensouda,
Zëvendësprokurore

Avokati i Mbrojtjes

Përfaqësuesit Ligjorë të Viktimave

Përfaqësuesit Ligjorë të Paditësve

Viktimat e Papërfaqësuar

**Paditësit e Papërfaqësuar për
Pjesëmarrje/Zhdëmtim**

Zyra e Avokatit Publik për Viktimat

Zyra e Avokatit Publik për Mbrojtjen

Përfaqësuesit e Shteteve

Miqtë e Gjykatës

SEKRETARIA

Sekretarja e Gjykatës

Z-(ush)a Silvana Arbia
Zëvendëssekretari i Gjykatës
Z. Didier Preira

Seksioni për Mbështetjen e Mbrojtjes

Njësia për Viktima dhe Dëshmitarë

Seksioni i Paraburgimit

**Seksioni i Pjesëmarrjes dhe Zhdëmtimit të
Viktimave**

Të tjerë

SEKRETARIA e Gjykatës Penale Ndërkombëtare (“Gjykata”)

DUKE MARRË SHËNIM referimin e situatës në Xhamahirinë Arabe të Libisë (“Libia”) prej 15 shkurtit 2011 te Prokurori i Gjykatës nga ana e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara në rezolutën e tij S/RES/1970 të 26 shkurtit 2011 (“Rezoluta”);

DUKE MARRË SHËNIM “Prosecutor’s Application Pursuant to Article 58 as to Muammar Mohammed Abu Minyar GADDAFI, Saif Al-Islam GADDAFI and Abdullah AL-SENUSSI” të datës 16 maj 2011;¹

DUKE MARRË SHËNIM “Decision on the “Prosecutor’s Application Pursuant to Article 58 as to Muammar Mohammed Abu Minyar GADDAFI, Saif Al-Islam GADDAFI and Abdullah AL-SENUSSI ”” të nxjerrë nga Dhoma Para-gjyqësore I më 27 qershor 2011;²

DUKE MARRË SHËNIM tri fletët e arrestit për Muammar Mohammed Abu Minyar GADDAFI-n, Saif Al-Islam GADDAFI-n dhe Abdullah AL-SENUSSI-n nxjerrë nga Dhoma Para-gjyqësore I më 27 qershor 2011;³

DUKE MARRË SHËNIM nenet 57 deri 60, 87, 89, 91 dhe 97 të Statutit të Romës, rregullat 117, 176, 184, 187 dhe 196 të Rregullave të Procedurës dhe Dëshmisë dhe rregulloret 31 dhe 111 të Rregulloreve të Gjykatës (“Rregulloret”);

¹ ICC-01/11-4-Red.

² ICC-01/11-12.

³ ICC-01/11-01/11-2; ICC-01/11-01/11-3; ICC-01/11-01/11-4.

DUKE MARRË PARASYSH se Dhoma i kërkoi Sekretarisë të përgatisë një kërkesë për bashkëpunim duke kërkuar arrestimin dhe dorëzimin e Muammar Mohammed Abu Minyar GADDAFI-t, Saif Al-Islam GADDAFI-t dhe Abdullah AL-SENUSSI-t që përmban informacionin dhe dokumentat e kërkuar me nenet 89(1) dhe 91 të Statutit dhe me rregullën 187 të Rregullave, dhe ta transmetojë një kërkesë të tillë te të gjitha Shtetet Palë të Statutit ;

KËRKON nga të gjitha Shtetet Palë të Statutit që të arrestojnë dhe dorëzojnë në Gjykatë individët:

<p>Mbiemri : Gaddafi Emri : Muammar Mohammed Abu Minyar Mbiemri po ashtu shkruhet : Qaddafi, Qadhafi ose Kadafi Data e lindjes : 1942 Vendi i lindjes : afër Sirtes, Libi Nacionaliteti : Libias Profesioni : Kommandant i Forcave të Armatosura të Xhamahirisë Arabe të Libisë, mban titullin Lider i Revolucionit dhe, si i tillë, ushtron detyrën e Kreut të Shtetit të Libisë Vendndodhja e mundshme: Libia Përshkrimi : bashkëngjitet fotografia</p>

<p>Mbiemri : Gaddafi Emri : Saif Al-Islam Mbiemri po ashtu shkruhet : Qaddafi, Qadhafi ose Kadafi Data e lindjes : 25 qershor 1972 Vendi i lindjes : Tripoli, Libi Nacionaliteti : Libias Profesioni : Kryesues Nderi i Organizatës Bamirëse Gaddafi International dhe Fondacioni për Zhvillim, vepron si <i>de facto</i> Kryeminister i Libisë Vendndodhja e mundshme: Libia Përshkrimi : bashkëngjitet fotografia</p>

Mbiemri : Al-Senussi
 Emri : Abdullah
 Mbiemri po ashtu shkruhet : N /A
 Data e lindjes : 1949
 Vendi i lindjes : Sudan
 Nacionaliteti : Libias
 Profesioni : Kolonel i Forcave të Armatosura të Libisë dhe momentalisht kryesues i Inteligjencës Ushtarake, më parë e njohur si Organizata e Sigurimit të Xhamahirisë
 Vendndodhja e mundshme: Libia
 Përshkrimi : bashkëngjitet fotografia

KËRKON nga të gjitha Shtetet Palë të Statutit t'u përmbahen procedurave që jepen në nenet 59, 89(2) dhe 89(4) të Statutit dhe rregullën 117 të Rregullave;

KËRKON nga të gjitha Shtetet Palë të Statutit ta njoftojnë Gjykatën për çfarëdo aplikacioni të bërë sipas neneve 59(3) dhe 89(2) të Statutit;

KËRKON nga të gjitha Shtetet Palë të Statutit ta informojnë Gjykatën, në pajtim me nenin 97 të Statutit, për ndonjë problem që mund të pengojë apo ndalojë ekzekutimin e kësaj kërkesë;

KËRKON nga të gjitha Shtetet Palë të Statutit ta informojnë Sekretarinë kur individët e kërkuar nga Gjykata janë të disponueshëm për dorëzim në pajtim me rregullën 184 të Rregullave;

I BASHKËNGJIT kësaj kërkesë, në përputhje me nenet 87(2) dhe 91(2) të Statutit dhe rregullën 187(1) të Rregullave, këto dokumente:

- i) një kopje të origjinalit të fletë arresteve;
- ii) kopje të fletë arresteve në një gjuhë të zgjedhur nga Shteti me rastin e ratifikimit të Statutit dhe në një gjuhë të cilën individët subjekt të fletë arresteve plotësisht e kuptojnë dhe e flasin;
- iii) një kopje të dispozitave relevante të Statutit në një gjuhë të cilën individët subjekt të fletë arresteve plotësisht e kuptojnë dhe e flasin.

/nënshkrimi/

Silvana Arbia, Sekretare e Gjykatës,

Sot më datën 4 korrik 2011

Në Hagë, Holandë